

UNMIK/DIR/2000/1
22 JANAR 2000

DIREKTIVA ADMINISTRATIVE NO.2000/1

ZBATIMI I RREGULLORES NO.2000/2 TË UNMIK-ut
TË 22 JANAR 2000 MBI AKCIZAT NË KOSOVË

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në përputhje me autorizimin e dhënë atij konform me Rregulloren No. 2000/XX të UNMIK-ut mbi akcizat në Kosovë,

Shpall direktivën administrative sa vijon:

Neni 1
Përjashtimet

1.1. Akcizat nuk do të vjelen nga sa vijon:

- (a) Lëndët e para dhe ato ndihmëse, që, përndryshe, do t'i nënshtroheshin akcizave, të importuara në Kosovë nga personat që kanë leje të lëshuara nga Shërbimi Doganor i UNMIK-ut, që autorizon importin e tillë, ku materialet e tilla do të përdoren në prodhimin e mallërave për eksport;
- (b) Mallërat, të cilat Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Doganor të UNMIK-ut vendos se përdoren vetëm për qëllime humanitare dhe të cilat nuk mund të ofrohen për shitje në Kosovë; dhe
- (c) mallërat e tjera të tilla, ashtu siç Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm do t'i specifikojë për përjashtim me anë të direktivës administrative, që u nënshtrohen kushteve të tilla ashtu si mendon ai ose ajo se iu përgjigjen.

1.2. Akcizat nuk do të paguhen nga sa vijon më poshtë:

- (a) misionet e huaja diplomatike dhe konsulare;
- (b) Kombet e Bashkuara, ose cilido organ i tyre duke përfshirë UNMIK-un, agjencionet e specializuara të Kombeve të Bashkuara, KFOR-i, organizatat ndërqeveritare ndërkombëtare dhe agjencionet qeveritare mbi mallërat e përdorura për qëllime zyrtare;
- (c) kontraktorët e UNMIK-ut, agjencionet e specializuara të Kombeve të Bashkuara dhe KFOR-i, që importojnë mallëra për t'u përdorur vetëm nga ata kontraktorë, që janë të lidhur me përmbushjen e kontratave për UNMIK-un, agjencitë e specializuara të Kombeve të Bashkuara ose KFOR-i;

- (d) organizatat joqeveritare të regjistruara me status të privilegjuar publik, siç është perkufizuar me Rregulloren no.1999/22 të datës 15 nëntor 1999 të UNMIK-ut mbi mallërat e mëposhtme për t'u përdorur vetëm nga organizatat joqeveritare për përmbushjen e qëllimeve të interesit publik: gazolina, vajguri, nafta, etanoli, telefonat mobil, antenat satelitore, aparatet televizive dhe video incizuesit; dhe
- c) organizatat dhe entitetet e tjera të tilla, ashtu siç do ta specifikojë për përjashtim Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm me anë të direktivës administrative, që u nënshtrohen kushteve të tilla ashtu siç mendon ai ose ajo se iu përgjigjen.

Neni 2
Mbledhja

Akcizat do të vlerësohen, vjelen dhe mblidhen siç vijon:

- (a) për mallërat e importuara: në vendkalimet e autorizuara kufitare ndërkombëtare dhe në depot e brendshme të doganimit; dhe
- (b) për mallërat e tjera që hyjnë në Kosovë ose mallërat e prodhuara në Kosovë; në zyrat për mbledhjen e taksave dhe vendet e prodhimit.

Neni 3
Procedurat dhe kundërvajtjet

Këto rregullore mbi procedurat e akcizave dhe kundërvajtjet do të mbesin të zbatueshme. Zyrtarëve, të cilët administrojnë këto çështje, do t'iu dorëzohen udhëzimet.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Kjo direktivë administrative do të hyjë në fuqi më _____ Janar 2000.

Bernard Kouchner
Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm